



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT

Nr. prot.

Tiranë, më, _____, _____ 2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM
TE KONTRATES ME OBJEKT PROKURIMI
“BLERJE PEMË DEKORATIVE PËR PYLLIN ORBITAL DHE ZONA TË NDRYSHME TË
TIRANËS”
PËR NEVOJAT E DPPGJ PER VITIN 2023**

OBJEKTI PROCEDURËS: “BLERJE PEMË DEKORATIVE PËR PYLLIN ORBITAL DHE ZONA
TË NDRYSHMETË TIRANËS”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): FPP
77211600-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 59 500 000 (pesedhjetë e nentemilion e peseqind mijë) lekë pa TVSH
ose 569 105.69 EURO (without Vat), referuar Kursit të këmbimit të Bankes së Shqipërisë date
05.07.2023, në vlerën 104.55 All.

“Procedurë e hapur ” mbi kufirin e lartë monetar, me mjete elektronike.

I mbajtur sot më datë **05.07.2023** në DPPGJ – Tirane, në prani të anëtarëve të Njesisë së Prokurimit të
ngritur me Urdhër të Titullarit të AK , për miratimin e dokumentave të tenderit « Tender i hapur » mbi
kufirin e lartë monetar ,bazuar në nenin 47 të VKM 285 dt. 19.05.2021 si dhe nenit 42 të Ligjit 162/2020
«Per Prokurimin Publik» me mjete elektronike. **me afat 4 muaj nga data e lidhjes së kontrates** mbi
sasinë e mallrave të cilat kërkohet të kontraktohen sipas tabelës si më poshtë vijon:

**SASIA E MALLIT QË KËRKOHET DHE FURNIZIM -VENDOSJE TE PARAQITURA NE
PREVENTIV NE MENYRE TABELARE;**

Nr	Emërtimi	Madhesia e bukes se dheut në (Lit)	Sasia në copë
	Baza materiale		
1	Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka)	130	100
2	F.V. Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka), rruga "Muhamet Deliu"	130	200
3	F.V. Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka)- Rruga Industriale	130	8
	F.V. Manjolë, (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Industriale	130	13
	F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Industriale	110	35
4	Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka)	130	100
5	F.V. Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 40_45 cm në 1.3 m nga toka), përballë ETC.	150	10
6	Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 50_55 cm në 1.3 m nga toka)	220	50
7	F.V.Pishe e Bute(Pinus Pinea), (me perimetër 45_50 cm në 1.3 m nga toka), Autostrada TR-DR	220	20
8	Pishe e Bute(Pinus Pinea), (me perimetër 35_40 cm në 1.3 m nga toka)	170	30
9	Gështenjë, (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka)	110	30
10	Kamfora, (me perimetër 35_40 cm në 1.3 m nga toka)	170	30
11	Rrap, (Platanus orientalis),, (me perimetër 80_85 cm në 1.3 m nga toka)	750	50
12	Rrap, (Platanus orientalis),, (me perimetër 60_70 cm në 1.3 m nga toka)	600	40
13	Rrap, (Platanus orientalis),, (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka)	110	500
14	F.V. Rrap, (Platanus orientalis),, (me perimetër 20_25 cm në 1.3 m nga toka). Rruga Monun	110	7
	F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka).Rruga Monun	110	87
15	F.V. Rrap, (Platanus orientalis),, (me perimetër 20_25 cm në 1.3 m nga toka). Rruga Egnatia	110	13
	F.V. Manjolë, (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Egnatia	130	19
	F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka). Rruga Egnatia	220	82
	F.V. Dafine (Laurus nobilis), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka).Rruga Egnatia	70	10
16	Manjolë, (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka)	110	30
17	F.V Pishe e Bute, (me perimetër 20_25 cm në 1.3 m nga toka), Lulishte prane Megatek	110	20
	F.V.(Lis, Quercus), (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka),Lulishte prane Megatek	70	50
	F.V. Likuidambër, (Liquidambar styraciflua), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka).Lulishte prane Megatek	70	35
	F.V.(Sofor (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), Lulishte prane Megatek	70	30
18	F.V Ulli, (Olea Europaea), (me perimetër 130_140 cm në 1.3 m nga toka), Lulishte prane mbikalimit te kasharit	220	10

19	Lis, Quercus), (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka)	90	50
20	Ilqe, (Quercus Ilex), (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka)	110	50
21	Lofatë, (me perimetër 23_30 cm në 1.3 m nga toka)	90	20
22	Panjë e Kuqe (me perimetër 40_45 cm në 1.3 m nga toka)	220	50
23	F.V. Rrap, (Platanus orientalis),, (me perimetër 20_25 cm në 1.3 m nga toka). Rruga Iliria	110	10
24	F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 40_45 cm në 1.3 m nga toka),Rruga Bylis	220	7
	F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 40_45 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Bylis	220	7
	F.V. Likuidambër, (Liquidambar styraciflua), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka).Rruga Bylis	70	38
	F.V. Likuidambër, (Liquidambar styraciflua), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka).Rruga Bylis	70	41
	F.V. Liriodendron (Liriodendron tulipifera), (me perimetër 18_20 cm në 1.3 m nga toka).Rruga Bylis	90	2
25	Lis, Quercus), (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Pavarsia	90	40
26	F.V. Sofor (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Dardania	70	30
27	F.V. Rrap, (Platanus orientalis),, (me perimetër 20_25 cm në 1.3 m nga toka). Rruga Butrinti	110	10
28	Tespie (me perimetër 45_50 cm në 1.3 m nga toka)	220	40
29	F.V.Qershi Japoneze (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Asim Zeneli	70	20
30	Qershi Japoneze (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka)	170	40
31	F.V. Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka). Rruga Besim Alla	70	50
32	F.V. Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka). Rruka Thoma Koxhaj	70	30
33	Dafinë me kurorë piramidale	130	20
34	Sofor (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)	70	200
35	F.V.Cedër, (Cedrus Deodara), (me perimetër 55_60 cm në 1.3 m nga toka), Kryeministria	750	10
36	Cedër, (Cedrus Deodara), (me perimetër 55_60 cm në 1.3 m nga toka)	750	10
37	Dafine (Laurus nobilis), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)	70	70
38	Mimozë, (Acacia Dealbata), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)	70	50
39	Gledicia, (Gleditsia triacanthos), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)	70	80
40	F.V.Ahu , (Fagus sylvatica), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), Zall-Bastar	70	10
41	Lisi i Kalifornisë, Quercus Agrifolia, (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)	70	80
42	Frashër , (Fraxinus angustifolia Vahl), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)	70	80
43	F.V.Ahu , (Fagus sylvatica), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), Shengjergj	70	7
44	Likuidambër, (Liquidambar styraciflua), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)	70	80
45	Kumbull e Kuqe, (Prunus Pissardi), (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka)	90	80
46	F.V. Kumbull e Kuqe, (Prunus Pissardi), (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka), tek rruga "E Kavajës)	90	150

47	Panjë e Kuqe (Acer japonicum), (me perimetër 18_20 cm në 1.3 m nga toka)	90	80
48	Liriodendron (Liriodendron tulipifera), (me perimetër 18_20 cm në 1.3 m nga toka)	90	80
49	F.V. Liriodendron (Liriodendron tulipifera), (me perimetër 18_20 cm në 1.3 m nga toka), tek rruga "Ana Konmena"	90	50
50	Lejlandër, (Cupressocuparis leylandii), h = 4 - 5 m	90	500
51	Banane h = 4 m	70	20
52	F.V Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Diga e Liqenit	130	7
53	F.V Lisi i Kalifornisë, Quercus Agrifolia, (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), Rruga e Vilave	70	30
54	Ekualipt, (Ekualiptus Globulus), (me perimetër 35_40 cm në 1.3 m nga toka)	220	20
55	Lofatë, (Cercis siliquastrum), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)	90	100
56	Manjolë, (Magnolia grandiflora), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)	90	100
57	Ulli, (Olea Europaea), (me perimetër 130_140 cm në 1.3 m nga toka)	220	50
58	F.V. Panjë e Norvegjisë, Acer platanoides 'Crimson King' (Norway Maple), (me perimetër 18_20 cm në 1.3 m nga toka). Rruga Lek Dukagjini	90	20
59	Selvi Cupressus sempervirens, h = 8 - 8.5 m e lartë	600	30
60	Selvi Cupressus sempervirens, h = 4 - 5 m e lartë	220	100
61	Bush	40	120
62	Nandia (Nandina domestica) h= 50cm	40	500
63	Nandina Nano h = 30cm	33	500
64	Loropetalum (Loropetalum chinense) h = 60 - 80 cm	33	100
65	Viburnum h = 1 - 1.5 m nga toka	70	1000
66	Oleandër, (Nerium oleander),	3	1000
67	F.V Oleandër, (Nerium oleander), Parteri I mesit Rruga e Dibres	3	5000
68	F.V Oleandër, (Nerium oleander), parteri I mesit Rruga Kastriotet	3	10000
69	Pleh organik(kg)		152500
70	Zhalona mbeshtetes (Cope)		970

Afatet e lëvrimit: 4- muaj nga data e nënshkrimit të kontrates dhe në sasi dhe kohë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor DPPGJ, konkretisht Njesia Prokurimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin, miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, duke u mbështetur ne procesverbalin e argumentimit te kriterëve teknike, fondit limit dhe specifikimeve nga grupi i punes se ngritur nga Titullari i AK me Urdher **Nr. 1207 Prot date 19.06.2023** me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “DPPGJ” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyetimit te meposhtem:

Kjo kontrate nuk eshte ndare ne lote pasi administrimi i saj do te behet nga DPPGJ si dhe ndjekja dhe zbatimimi i kontrates do te behet nga vetë DPPGJ, ndarja dhe frangmentimi i saj do te krijonte kompleksitet dhe veshtiresi ne zbatim.

Objekti i kontrates lidhet me blerje pemesh dekorative ne te cilen pjesa me e madhe perfshin furnizim vendosje te cilat kane karakteristika dhe tipologji te njejte dhe keto mallra tregohen nga operator ekonomik te cilet ofrojne te gjitha kategorite e pemeve te kerkuara. Persa me lart ndarja ne lote do ta nderlikonte dhe veshtiresonte procesin e zbatimit te kontrates duke krijuar vonesa dhe shpenzime operative shtese dhe rrjedhimisht do sillte veshtiresi dhe vonesa per menaxhimin e pemeve dekorative.

Vendndodhja e pemeve dekorative furnizim vendosje:

Pemet dekorative (furnizim vendosje) do te mbillen në 27 njësitë administrative të Bashkisë Tiranë, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Referuar Kerkeses nga Drejtoria e Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes së Gjellbërimit të Qytetit ndër zonat *të cilat rezultojnë më kryesore* dhe që kanë nevojë për mbjellje pemesh dekorativë janë te percaktuara sipas njesive administrative perkatese:

Mallrat objekt prokurimi do te verifikohen e merren ne dorëzim, rast pas rasti nga nje komision i posacëm i ngritur nga AK.

Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës: Mallrat e kerkuara do te dorezohen sipas kerkesave dhe nevojave faktike te DPPGJ.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Bimësia dekorative (drurë_shkurre) dhe kompozimi në gjellbërim.

Në sipërfaqet e gjellbëra elementi bazë dhe faktori kryesor që përcakton kompozimin e tyre estetik mbetet gjithmonë bimësia dekorative.

Bimësia dekorative mund të lihet me rritje natyrore ose mund ti jepet edhe forma te rregullta sferike dhe gjeometrike, paralelepipedë, konike, etj.

Veçoritë e drurëve dekorativë:

- drurë me kurorë ovale; Panja, Mështekëna, Ahu, Gështenja, Sofora, Bli, Lisi, etj.
- drurë me kurorë të rrumbullakët; Gështenja e Kalit, Katabla, Plepi, Shelgu etj,
- drurët me kurorë konike; Likuidambër, Manjolë, Rrapi, Bli, Akacia etj.
- drurë me kurorë si kolonë; Mështekën, Ah, Verri, etj.
- drurë me kurorë sferike; Panja, Frashëri, Akacia etj.
- drurë me kurorë të shtrirë si çadër; Julibrisimi, Plepi i Bardhë, Cedruset, Pishat, etj.
- drurë me kurorë konike; Bredhi, Selvia, Varshi, Gjinko, Kryptomeria, Pisha, Sekuoja, Tisi, Selvi e Kënetave, etj.
- drurë me kurorë vajtuese; Shelgu vajtues.

Megjithëse drurët në përgjithësi i kanë gjethet në ngjyrë jeshile, kjo nuk është e njëlllojtë për të gjitha llojet e drurëve, por ndryshon në nuancën e saj.

Sipas ngjyrës së gjetheve dallojmë:

- Drurë me gjethe jeshile të errëta, që ne vjeshta kalojnë në të verdha. Gështenja e kalit, lisi i kuq, Blinjtë, Panjat, Plepi i Kanadasë etj. Drurë me gjethe jeshile të qelta, që ne vjeshtë kalojnë në të verdhë të çelët; mështekna, bliri, akacia, sofra, panja negundo, rrapi etj.

- Drurë me gjethe bojqëqielli në jeshile që ne vjeshtë kalojnë në ngjyrë të verdhë si të kuqe; ahu, panja, etj.

- Drurë me gjethe të verdha e jeshile të cilat në vjeshtë kalojnë në okër; mështekna, arra gështenja e butë etj.

Veçori të shkurreve dekorative

Sipas lartësisë ndahen në: shkurre të larta - mbi 3 metra; shkurre mesatare 1-3 metra; shkurre të ultë deri 1 metër.

Sipas formës së kurorës ndahen në: shkurre më kurorë ovale; jargavani, oleandri etj.; shkurre më kurorë konike; manjola, dëllinja, tisi etj.; shkurre me kurorë si çadër; dëllinja; shkurre me kurorë të hapur që është edhe pjesa më e madhe e tyre; shkurre me kurorë zvarranike, etj.

Mjediset e gjelbëra kanë në përbërjen e tyre të gjithë drurët (pemët), shkurret dhe çdo lloj vegjetacioni tjetër që rritet në vende ku jetojnë, punojnë dhe kryhet aktiviteti njerëzor.

Prioritet i shtimit të gjelbërimit është futja e bimësisë hibride dhe sidomos asaj autoktone (vëndase) me rritje të shpejtë dhe efekteve jo vetëm në aspektin dekorativ (zbukurues) por edhe në të gjitha të mirat e tjera në shërbim të plotë të komunitetit.

Në zgjedhjen e llojeve të bimësisë dekorative drurë (pemë) dhe shkurre është marrë parasysh kombinimi i drejtë i tre elementëve kryesorë:

- a) Qëllimi i mbjelljeve,
- b) Kushtet e mjedisit dhe
- c) Veçoritë biologjike të llojit.

Me qëllimin që menjëherë mbas mbjelljes mjedisi të ketë atraksionin e duhur në tërësinë e vet dhe sidomos ndaj komunitetit, drurët dhe shkurret dekorative pëzgjidhen me karakteristika dendrometrike të avancuara, në vartësi kjo edhe të llojeve dhe kërkesave të tyre ndaj faktorëve klimatikë dhe edafikë.

Kështu preferohet që lartësia e trungut të drurëve (pemëve) duhet të jetë 2.5 deri 3.5m, lartësia e kurorës rreth 2m, perimetri (cirkoferenca) në qafën e rrënjës ose në 1.30 m nga toka, duhet të jetë 30 deri 35 cm, kurora të jetë simetrike në formën karakteristike të llojit me buke dheu.

Kushtet e mjedisit janë përcaktuese për zgjedhjen e llojeve të përshatshme për rritje dhe zhvillim normal, në plotësim të kërkesave jo vetëm për krijimin e një peisazhi sa më atraktiv por edhe në fuksion të të mirave materiale komplekse për komunitetin.

Po kështu në përzgjedhjen e llojeve të bimësisë dekorative drurë dhe shkurre mbahet parasysh përbërja dhe veçoritë biologjike të llojeve në përshtatje të plotë me bimësinë dekorative në një zonë të caktuar, në një bllok banimi apo gjelbërimi përgjatë rrugëve etj.

Në llojet e bimësisë së përzgjedhur ka një alternim midis bimësisë dekorative halorë, fletorë dhe shkurre, përherëblertë dhe gjetherënës, si dhe midis formave dhe koloreve, për të krijuar panorama dhe peisazhe të soditshëm dhe të ndryshueshëm në raport me ndryshimin e stinëve.

TEKNIKA E MBJELLJES SË DRURËVE DEKORATIVË

Në krijimin e sipërfaqeve të gjelbëra, për të mundur efekt të shpejtë dhe të parakohshëm, ka filluar të përdoret rëndom edhe mbjellja e drurëve dekorativë të rritur. Kjo teknikë presupozon mbjelljen e bimësisë dekorative më parë nga fidanishtja në vazh.

Kjo teknikë ka filluar të përdoret gjerësisht edhe në institucionin tonë. Kështu përdoret në gjelbërimin e trotuareve të rrugëve të reja dhe të atyre të vjetra ku në radhën e drurëve ekzistues, duhen zëvendësuar drurë të veçantë, të cilët;

- si rezultat i veprimit të faktorit objektiv (që përfshin kushtet natyrore), vjetërohen, deformohen, rrëzohen etj., dhe po kështu;

- si rezultat i veprimit të faktorit subjektiv (që përfshin veprimtarinë e njeriut) dëmtohen tërësisht ose pjesërisht, me ose pa dashje, dhe humbasin kështu funksionin e tyre dekorativ si dhe prishin njëllojshmërinë e gjelbërimit kudo në tërësinë e vet, në rrugë e blloqe banimi, në sheshe e bulevarde, në lulishtet e qytetit, në lulishtet e institucioneve shtetërore etj.

Para se të fillojme mbjelljen e pemëve në vazo, në fund të saj duhet të vendosim gurë, guralecë ose qeramikë të thyer për të parandaluar bllokimin e vrimave me dhe' dhe për të lejuar kullimin e lirë. Më pas brenda vazos hidhet toka, kjo duhet të sigurojë ajrim dhe kullim të mjaftueshëm duke ruajtur sasi të përshtatshme lagështie. Një kompost për qëllime të përgjithshme do t'i sigurojë të gjitha këto dhe mund të plotësohet edhe me plehra organike. Pema e mbjellë në këtë vazo nuk është në gjendje t'i përhapë rrënjët e saj për të arritur ujin, prandaj është e domosdoshme ta ujisim pemën rregullisht. Në këtë rast uji i freskët i shiut është më i miri.

Nëse jemi të detyruar që pemën nuk mund ta mbjellim në tokë brënda vitit por do ta mbajmë më shumë, atëhere duhet të sigurohuni që pema të jetojë në rehati duke rifreskuar shtratin e saj çdo vit. Këtë veprim mund ta bëjmë duke hequr dheun e sipërm të lirshëm dhe duke e zëvendësuar atë me dhe' të pasur me pleh.

Epërsitë e kesaj metode janë:

- Zënie e garantuar dhe zhvillim normal i procesit jetësor të drurëve dhe shkurreve.
- Transport i lehtë dhe i shpejtë në objektet e mbjelljes.
- Heqje e shpejtë dhe mbjellje e lehtë e bimësisë dekorative në gropat e hapura më parë.

Shkulja dhe mbjellja e drurëve të rritur në praktikën e ndërtimit të gjelbër bëhet më me vështirësi se sa për fidanët e vegjël, prandaj ky proces kërkon punonjës dhe punëtorë me nivel të lartë kualifikimi, mjete të posaçme të shkuljes, ambalazhimit, ngarkimit në makineri, transportit deri në objekt, shkarkimin dhe deri mbjelljen e tyre duke zbatuar rigorozisht teknikën e domosdoshme.

SHKULJA E DRURËVE

Para fillimit të shkuljes, duhet të caktohet se sa do të jetë diametri i bukës së dheut. Ky praktikisht përcaktohet duke marrë 8-10 herë diametrin e trungut të fidanit në lartësi 1.30 m (afërsisht në lartësinë e gjoksit të njeriut) nga toka. Po kështu thellësia e bukës së dheut përcaktohet nga madhësia dhe shtrirja e sistemit rrënjor të fidanit. Në përgjithësi kjo thellësi është rreth 80-100 cm. Forma e bukës së dheut duhet të jetë kubike, piramidë e prerë me bazë katrore ose cilindrike. Në qendër duhet të jetë trangu i pemës.

Gjatë shkuljes së fidanëve të rritur duhet të ruhet dhe të mos dëmtohet sistemi rrënjor bazë (kryesor), por të priten vetëm rrënjë të veçanta të trasha, të thyera gjatë prerjes ose të kalbura. Prerja e këtyre rrënjëve duhet të bëhet e rrafshët dhe përpjendikulare për të mos shkaktuar çarje të rrënjëve, pasi kjo mund të sjellë kalbëzimin e tyre dhe mbas një kohe edhe tharjen e vetë fidanit. Pasi të jetë caktuar madhësia dhe forma e bukës së dheut, Pasi të ketë përfunduar mbështjellja e bukës së dheut bukës së dheut, fidani është gati për transportim në vendin e ri. Drurëve të rritur, një vit më parë, duhet t'u bëhet prerja e sistemit rrënjor duke pasur parasysh madhësinë e bukës së dheut me të cilën do të shkulet.

TRANSPORTIMI I DRURËVE

Drurët e rritur të inkasuar, detyrimisht duhet të transportohen me automjet. Duke qenë se pasha e bukës së dheut dhe e fidanit është shumë e madhe ngarkimi i fidanit në automjet bëhet me vinq. Me qëllim të gjatë transportit, të mos dëmtohen degët e fidanit, ato duhet të lidhen me litar në formë spirale.


Në automjet, fidani vendoset i shtrirë në mënyrë të tillë që e dheut të shtrihet në pjesën e karrocërisë së automjetit. Duhet theksuar se aty ku mbështeten degët e fidanit, duhet të vendosen material të buta ambalazhimi, me qëllim që të mos shkaktohen dëmtime. Që fidani gjatë ngarkimit e shkarkimit të rrotullohet në çdo pozicion, ai duhet të lidhet me litar të gjatë dhe të ngrihet me vinq. Mbas ngarkimit të fidanit, bashkë me automjetin nisët për në vendin e mbjelljes edhe vinqi. Kur fidani transportohet në largësi të largëta e në kohë me diell, pjesa e inkasuar e bukës së dheut duhet mbuluar me rrogözë, të cilët duhet të mbahen të lagura gjatë gjithë kohës së transportimit. Nuk këshillohet asnjëherë që fidanë të tilla të shkulet, transportohen e mbillen kur temperatura zbrit në (-10 grade). Për një mbjellje të suksesshme dhe ecuri normale vegetative është kusht i domosdoshëm, që fidanit para se të shkulet e të transportohet, duhet t'i shënohet në trung me bojë vaji drejtimi veri-jug që ka pasë në vendin ekzistues, sepse edhe në vendin e ri të mbledhjes fidani duhet të vendoset po në atë drejtim. Mosrespektimi i këtij kushti shpesh shkakton zhvillim jonormal të kurores së fidanit.

MBJELLJA E DRURËVE

Koha e përshtatshme për mbjellje. Drurët dhe shkurret zakonisht mbillen vetëm gjatë periudhës së pushimit të vegetacionit, pikërisht atëherë kur proceset jetësore të tyre zvogëlohen në minimum.

Gropa në të cilën mbillen drurët e rritur duhet të hapet disa ditë më përpara se të kryhet mbjellja. Në varësi të përmasave të bimësisë së kërkuar hapet dhe gropa, konkretisht për drurë (pemë) me përmasa të diametrit deri 6 cm dhe bukë dheu 60 cm, gropa hapet me përmasa 80x80x80cm. Fidani (druri_pema) vendoset përpindikularisht, 30-40cm mbi dheun e hedhur paraprakisht në gropë, i cili duhet të jetë dhe' i mirë vegjetal dhe pa gurë apo inerte, druri mbahet drejt nga një punëtor dhe nga dy punëtorët e tjetër fillohet të mbushet nga të gjitha anët me dhe' i cili vazhdimisht ngjishet me këmbë, si në figurën e mëposhtme (figura nr.1).

Në përfundim të procesit duhet të ujitet me ujë të bollshëm. Kur gropa është mbushur plotësisht me dhe, rreth e përqark saj formohet një unazë dheu e cila do të shërbejë më vonë për mbajtjen e ujit gjatë ujitjes dhe reshjeve të shiut. Këtë ujë fidani (druri_pema) do ta thithë gradualisht për një kohë më të gjatë.



Mënyra e hapjes së gropës dhe mbjellja e fidanit (drurit_pemës) figura nr.1

Për ta ruajtur nga përkulja dhe shtrembërimet që mund të shkaktohen nga era, fidani (druri_pema) atje ku fillon kurora lidhet nga të tëra anët me tel i cili fiksohet në kunjat e futur në tokë. Trupi i fidanit (druri_pema) në vendin ku lidhet me tel duhet të mbështillet me material të butë amballazhimi. Kjo lidhje i hiqet vetëm pas 2-3 vjetëve.

SHËRBIMET PAS MBJELLJES

Është e domosdoshme që vitin e parë pas mbjelljes, bimësia dekorative drurë dhe shkurret duhet të ujitën rregullisht çdo tre ditë. Toka poshtë kurorës duhet të shkriftohet e prashitet, kurse gjatë verës kur temperatura është e lartë është e nevojshme që t'u bëhet edhe vaditja e spërkatja me ujë e kurorës.

KARAKTERISTIKAT DENDROMETRIKE PËR DISA LLOJE DRURË DHE SHKURRE

- Bli, (*Tilia platyphyllos*), (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka)
- Cedër, (*Cedrus Deodara*), (me perimetër 55_60 cm në 1.3 m nga toka)
- Banane h = 4 m
- Dafinë me kurorë piramidale
- Dafine (*Laurus nobilis*), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)
- Ekualipt, (*Ekualiptus Globulus*), (me perimetër 35_40 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V Ahu , (*Fagus sylvatica*), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V. Bli, (*Tilia platyphyllos*), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V Bli, (*Tilia platyphyllos*), (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V Ah, (*Fagus sylvatica*), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V Lisi i Kalifornisë, *Quercus Agrifolia*, (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V.(Lis, *Quercus*), (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V Ulli, (*Olea Europaea*), (me perimetër 130_140 cm në 1.3 m nga toka)
- Ulli, (*Olea Europaea*), (me perimetër 130_140 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V. Dafine (*Laurus nobilis*), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V. Kumbull e Kuqe, (*Prunus Pissardi*), (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka)

- F.V. Likuidambër, (*Liquidambar styraciflua*), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V. Liriodendron (*Liriodendron tulipifera*), (me perimetër 18_20 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V. Manjolë, (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka)
- Panjë e Kuqe (*Acer japonicum*), (me perimetër 18_20 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 40_45 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V. Panjë e Norvegjisë, *Acer platanoides* 'Crimson King' (Norway Maple), (me perimetër 18_20 cm në 1.3 m nga toka)
- Rrap, (*Platanus orientalis*), (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V. Rrap, (*Platanus orientalis*), (me perimetër 20_25 cm në 1.3 m nga toka)
- Rrap, (*Platanus orientalis*), (me perimetër 60_70 cm në 1.3 m nga toka)
- Rrap, (*Platanus orientalis*), (me perimetër 80_85 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V. Sofor (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V. Qersh i Japoneze (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)
- Frashër, (*Fraxinus angustifolia* Vahl), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)
- Gështenjë, (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka)
- Kamfora, (me perimetër 35_40 cm në 1.3 m nga toka)
- Ilqë, (*Quercus Ilex*), (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka)
- Gledicia, (*Gleditsia triacanthos*), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)
- Kumbull e Kuqe, (*Prunus Pissardi*), (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka)
- Lejlandër, (*Cupressocyparis leylandii*), h = 4 - 5 m
- Manjolë, (*Magnolia grandiflora*), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)
- Manjolë, (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka)
- Lis, *Quercus*), (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka)
- Lofatë, (*Cercis siliquastrum*), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)
- Lofatë, (me perimetër 23_30 cm në 1.3 m nga toka)
- Lofatë, (*Cercis siliquastrum*), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)
- Lis, *Quercus*), (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka)
- Mimozë, (*Acacia Dealbata*), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)
- Lisi i Kalifornisë, *Quercus Agrifolia*, (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)
- Likuidambër, (*Liquidambar styraciflua*), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)
- Liriodendron (*Liriodendron tulipifera*), (me perimetër 18_20 cm në 1.3 m nga toka)

SHKURRE

- Oleandër, (*Nerium oleandër*),
- Bush (*Buxus sempervirens*)
- Viburnum h = 1 - 1.5 m nga toka
- Nandia (*Nandina domestica*) h= 50cm
- Nandina Nano h = 30cm
- Loropetalum (*Loropetalum chinense*) h = 60 - 80 cm

GRAFIKU I EKZEKUTIMIT; bashkelidhur DST

Afati ekzekutimit: 4 muaj nga data e nënshkrimit të kontrates sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Per objektin ne reference.

NJP eshte bazuar në nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e nevojave, specifikimeve teknike, fond limit dhe kritereve te vecanta teknike.

Data e hapjes së ofertave planifikuar date 07..08.2023 Ora: 11:00

- www.app.gov.al
- *Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip dhe Anglisht*
- *Dokumentat pa pagesë.*

Njësia e prokurimit, bazuar në parashikimet ligjore dhe në objektin e prokurimit, vendosi kriteret e kualifikimit, të cilat gjejnë pasqyrim në Shtojcën 7 të DST –ve, kritere, të cilat u konsideruan si të nevojshme për përmbushjen e kontratës, në përpjestim me përmasat dhe veçoritë e objektit që prokurohet dhe konkretisht, si më poshtë vijon:

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit, jane të pa ndryshueshme nga ato të miratuar nga APP në setin standart të dokumentave të tenderit.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; në vlerën 2% të fondit limit.*
- c. Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- d. Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1.Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarim, sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2020,2021,2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet shoqëruar me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për të rritur pjesmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësia ka kërkuar që paraqitet deklaratë për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjykojnë me të arsyeshme të sjellin edhe bilancet.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin Nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kriteri do të konsiderohet i përmbushur edhe në rastet kur operatorët ekonomik zgjedhin të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022).

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues

përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:*

*”c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:***

- i) *totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;*
- ii) *ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;*
- iii) *iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE duhet të paraqesë bilancet siç kërkohet në pikën 2.2.1.

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë sugjerojmë saktësimin e këtij përcaktimi, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen.*

2.2.2 Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të*

treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë sugjerojmë saktësimin e këtij përcaktimi, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43/2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë llojin e mallrave dhe koheshtrirjen e kontrates për këtë objekt procedure prokurimi, kërket që OE ofertues të deshmojë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kerkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim është kërkuar vërtetimi i xhiros për tre vitet e fundit në të cilën vlera e xhiros minimale vjetore që u kërket operatoreve ekonomike nuk mund të tejkalojë *dyfishin e vlerës së parashikuar të kontrates, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar.*

Përcaktimi i viteve të kerkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 13 pika 2.

2.2.3 Vërtetimi për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin për vitin 2023 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga

Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, për sistemin e taksave vendore i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të percaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2022, ligjin nr.131/2015 “Për Qendren Kombëtare të Biznesit” neni 3.1(a,b,c). Dokumentat e kerkuara me siper, do të paraqiten nga operatori ekonomik fitues para dhenies së kontrates ose nëse kerkohen sqarime nga A.K.

Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore”i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë sugjerojmë saktësimin e këtij përcaktimi, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen.

Kritere të veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik , jane argumentuar nga grupi i punes i ngritur me Urdher Nr. 1207 Prot date 19.06.2023, specialistet e fushes nisur nga natyra dhe permasat e kontrates, specifikimet teknike, grafiku i levrimit , fushes se veprimtarise se institucionit, konkretisht si vijon:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më të vogël se 39% e vlerës së fondit limit.** Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë sugjerojmë saktësimin e këtij përcaktimi, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë, licencë profesionale:

Sipas modelit të lëshuar nga institucionet e autorizuar me dispozitat në fuqi për lëshimin e dokumentit të tillë. Liçenca duhet të përmbajë të paktën kategoritë në klasifikimin e mëposhtëm:

- **NP-1 A**
- **NP- 12 C**
- **NS-18 A**

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008

Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 5/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2014 ku janë të përcaktuara kategoritë përkatëse dhe niveli i klasifikimit për licensat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit.

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

*Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **NP - 1A** “Punime gërmimi në tokë”: Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.*

Kjo kategori liçence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv si hapje gropash, punime gërmim dheu, prerje betoni, prerje asfalti, të cilat gjithashtu parashikojnë edhe gërmim dheu.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **NP - 12 C** “Punime të inxhinierisë mjedisore”: *Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimet të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.*

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv për mbjelljen e (pemëve) drurëve dekorativ referuar vlerësimet të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **NS – 18 A** “Punime topogjeodezike”: *Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv për rlevimin dhe matjen e hapësirave të gjelbërta të pasqyruara në projekt dhe preventiv.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P - 1 A		Germim dheu me ekskavator me zinxhir.	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar

	Punime gjermimi në tokë.	Transport material dhe oe/apo inerte me auto deri 10.0 km; Depozitim inertesh/dhera ne landfill		në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar.
N.P-12 C	Punime të inxhinierisë mjedisore	Sistemim i terrenit dhe riparim sipërfaqe e gjelbert me f.v drurë dekorativ. Bimësia dhe peisazhi sipas grafikut/relacionit.	C	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.
N.S – 18 A	Punime topogjeodezike	Matja e hapësirave te gjelberta te pasqyruara ne preventiv dhe në vendin ku do të kryhen mbjelljet. Rilevim Topografik ne referim te preventivave.	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.

Argumentimi ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 5/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2014 ku janë të përcaktuara kategoritë përkatëse dhe niveli i klasifikimit për licensat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit.

Llojet e licensave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor** që të kenë stafin inxhinierik si më poshtë të cilin ta kete të punësuar të pakten në 3 muajt e fundit **dhe të kenë të pakten 5 vite eksperiencë pune, si dhe të përfshirë në licencën e shoqërisë** si më poshtë:

a. Inxhinier Topograf	1 (një)
b. Inxhinier Agronom	2 (dy)
c. Inxhinier Mjedisi	1 (një)
d. Inxhinier Pyjesh	1 (një)

Në rastin e shpalljes fitues të Operatorit Ekonomik, para lidhjes së kontratës, Autoriteti Kontraktor do të kërkojë nga OE fitues të paraqes për fuqinë punëtore dokumentacionin (original ose kopje e noterizuar) të sipërcituar.

Gjithashtu për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- CV
- Kontratë pune të vlefshme
- Diplomë
- Liçence (nëse është e zbatueshme / nëse Inxhinieri është i pajisur me liçencën përkatëse, referuar nenit 40/5/(b) të VKM 285, datë 19.05.2021)
- Libreze pune
-

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njëjësuar me origjinalin.. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njëjësuar me origjinalin. Ku specifikisht sipas pikës “dh” të Nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, “operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së.

Argumentimi: Në bazë të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77, pika 4, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 40, pika 5 b/c), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Nevoja për inxhinierët e sipër cituar është e diktuar nga përvoja e mëparshme e AK në këtë lloj kontratash. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të kontratës. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të agronom, inxhinierit të mjedisit, inxhinierit topograf, inxhinierit të pyjeve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e shërbimeve / punimeve të mbjelljeve në terren. Operatorët ekonomikë, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Punimet referuar preventivit përfshijnë prerje asfalti, prerje betoni, heqje pllakash rrugore, hapje gropash në rrugë, mansonje pune të cilat përfshijnë punën e inxhinierëve të sipër përmendur. Punime për hapjen e gropave të reja, të cilat lidhen me ndërhyrjen në rrugët egzistuese sipas preventivit përkatës. Punime bazuar në azhurnimet e rrjetit përkatës të rrjetit elektrik të instaluar në këto rrugë. Punime për hapjen e gropave të reja, të cilat lidhen me ndërhyrjen në rrugët egzistuese sipas preventivit përkatës. Punime bazuar në azhurnimet e rrjetit për katë të rrjetit hidraulik të instaluar në këto rrugë.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar **staf teknik** të cilin ta ketë të punësuar në 3 muajt e fundit si më poshtë:

a. Specialistë punimesh për lartësi	3 (tre)
b. Manovratorë-automakinistë	3 (tre)
c. Manovratorë – Eskavatoriste	1 (një)
d. Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave	1 (një)
e. Specialist për përgjegjësinë dhe shëndetin në punë	1 (një)
f. Teknik mekanik	1 (një)

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- kontratë punë të vlefshme
- diplome/dëshmi përkatëse leshuar nga institucione të akredituara/licencuara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore

- dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve
- Listepagesat E-SIG 25 te 3 muajve te fundit .me vule elektronike te vlefshme te verifikueshme ne system.

OE mund të sigurojë shërbimin nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore **për automakinistët me kontratë të vlefshme pune që mbulon të gjithë periudhën e ekzekutimit të shërbimit në kontratë..*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Nisur nga lloji i mallit dhe një pjese të punimeve (furnizim vendosje) i cili kërkohet, specialisti i fushës i AK ka gjykuar të domosdoshëm stafin i cili do ti duhet kontraktorit për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e preventivit. Nevoja për stafin ne terren (vendodhje të ndryshme në Bashkinë Tiranë, ku do të mbillen pemët) është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për shërbimin në fjalë. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të kontrates.

- *Kërkesa për 1 (një) teknik mekanik diktohet nga lloji i procedurës dhe se një pjesë e punëve që do të kryhen (furnzim-vendosje drurësh). Duke patur parasysh se shërbimi i mbjelljes së drurëve dekorativ kërkon mjete të specializuara dhe duhet të kryhet brënda një kohe të caktuar, kjo pasi bimësia e kërkuar ka specifika të caktuara të cilat lidhen me periudhën kohore të mbjelljes. AK e shikon të domosdoshëm këtë kriter pasi në gjykimin e specialistit të fushës është një faktor i cili jep garanci dhe besueshmëri AK për realizimin me sukses të kontratës nga ana e OE.*
- *Kërkesa për 3 (tre) automakinistë i referohet gjithashtu faktit se procedura përveç se parashikon blerjen e mallit, parashikon për një pjesë edhe shërbimin e transportit dhe mbjelljes së drurëve dekorative. Kërkesa në fjalë është e diktuar nga përvoja, legjislacioni dhe lloji i shërbimit. Gjithashtu specifikojmë se në këtë procedurë janë kërkuar mjete si kamion me vinç dhe kamionçina vetë-shkarkuese për realizimin e kontratës. Kërkesa bazohet në: Urdhër nr. 109, datë 5.08.2013 ‘Për Miratimin e Rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të*

kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimi”

- *Kërkesa për 1 (nje) eskavatoristë lidhet ngushtë me llojin e procedurës punime furnizim-vendosje. Lloji i shërbimit parashikon punime të tilla si hapje gropash të reja, prerje asfalti, thyerje betoni, heqje pllakash, gërmime dhe mbushje me dhe, evadimin dhe transportin e dheut dhe punime të ngjashme me to.*
- *Kërkesa për për 1 (një) punonjës ‘Ekspert për ndihmen e parë dhe nderhyrjen ndaj emergjencave’, i referohet faktit se preventivi parashikon punime dhe vendosje drurësh dekorativ sipas specifikimeve teknike. Në përputhje me klauzolat e ligjit 10327 datë 18.02.2010 Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.*

Personeli përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është përgjegjës për shpërndarjen e punës dhe realizimin e punimeve në formën dhe mënyrën e kërkuar sipas akteve ligjore në fuqi dhe në përputhje me manualet teknike dhe kushtet teknike të zbatimit, sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë të punonjësve të cilët do të jenë përgjegjës në furnizimin dhe punimet për të përmbushur kushtet e kontratës.

- *Kërkesa për 3 (tre) specialistë punimesh në lartësi, i referohet faktit se procesi vendosjes në terren të bimësisë dekorative do të kryhet me anë të mjeteve si kamion me vinç, kështu gjykojmë se prania e të paktën 3 specialistëve për punime në lartësi është një kërkesë e domosdoshme për mbarëvajtjen e sukseshme të procesit të furnizim/vendosjes së drurëve dekorativ.*

2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për kete objekt kontrate shërbimi duhet të disponojë fuqi punëtore duke përfshirë ketu, të stafit inxhinierik dhe tekniko-profesional prej minimalisht 49 persona si dhe të figurojnë në listpagesat e punonjësve për 3 muajt e fundit me:

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Listë - pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e fuqisë punëtore, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës. .

Argumentimi: Në bazë të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77, pika 4, si dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 40, pika 5 germa c, me anë të këtij kriteri kërkohet që, operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin (orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratën, referuar kodit të punës në Republikën e Shqipërisë). Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin kontraktor. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën, përmasat dhe kohën në dispozicion për zbatimin e kontratës. Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si natyra e mallit objekt kontrate që kërkohet të furnizohet (kemi marrë në konsideratë faktin se malli objekt kontrate ka nevojë ditore për mirëmbajtje dhe shërbime gjatë kohës së qëndrimit në ambientin e vënë në dispozicion nga OE, që nga momenti i lidhjes së kontratës deri në tërheqjen e mallit dhe shprëndarjen e tij në terren). Për procesin e ngarkimit, shkarkimit dhe pozicionimit të mallit objekt kontrate përllogariten gjithashtu numri i punonjësve. Gjithashtu për punimet e kërkuara sipas përshkrimit në preventiv për vendosje e pemëve. Numri i punonjësve, kualifikimi i tyre, grafiku i lëvrimit dhe natyra e mallit objekt prokurimi, me kohështrirje nga lidhje e kontratës deri në Dhjetor 2023, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë me sukses kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrate tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe

shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 49 punonjës duke përfshire dhe stafin tekniko menaxherial si dhe stafin administrativ, është në përputhje me volumin e punës, natyrën ku do të kryhen punimet.

Duke qënë se procesi i punës është i ndarë në dy drejtime (furnizim-vendosje) ku në dejetimin e vendosjes OE do të ndodhet në terren në zona të ndryshme nevojitet stafi i nevojshëm sipas profileve të sipërcituara për realizimin e kontratës. Gjithashtu edhe tek furnizimi, edhe tek vendosja, duke qënë se sasia e pemëve është e madhe dhe afati i lëvrimit është i shkurtër, si dhe bazuar tek mjetet të cilat do të funksionojnë me dy apo tre turne, në zbatim të kodit të punës. Për shkak gjithashtu edhe të terrenit dhe rrugëve brënda qyetetit, trafikut të rënduar, kufizimeve në orar në qarkullim, grafikut të punës është i nevojshëm angazhimi i numrit të 49 punonjësve të këkuar sipas profileve përkatës.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përlllogaritja është kryer bazuar natyres dhe permasave të kontrates, afatit të zbatimit të saj si dhe në respekt të Kodit të Punës, manualeve të ndërtimit të vitit 2015.

2.3.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, për të përmbushur këto kriter duhet të paraqesi konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015 (ose ekuivalente)** (e vlefshme).
- b) Çertifikatën e menaxhimit Mjedisor **ISO 14001-2015 (ose ekuivalente)** (e vlefshme).
- c) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit **ISO 45001-2018, (ose ekuivalente)**

Çdo OE pjesëmarrës (çdo anëtar i grupit) në rastet e 'Bashkimit të Operatorëve Ekonomik (BOE)' duhet të paraqesë çertifikatat ISO, sipas zërave të shërbimeve që do marrë përsipër të realizojë sipas kerkeses se AK.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Vendorsja e kriterëve lidhur me certifikimet ISO bazohet në përputhje me parashikimin e nenit 36 pika 3/b dhe nenit 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenit 44 pika 1, të VKM-se, Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe ligjit Nr. 116/2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë", ku percaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente, konkretisht: Vendorsja e ketyre kriterëve është e bazuar në faktin që certifikatat ISO garantojnë që operatorët ekonomik zbatojnë në punën e tyre procedurën të certifikuar ndërkombëtare për të garantuar shërbime me kualitet.

ISO 9001:2015

ISO 9001 është standardi më popullor i publikuar në nivel ndërkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë të cilat mund të implementohen dhe certifikohen nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensionit të saj apo fushës së aktivitetit.

Kërkesat e ISO 9001:2015 i referohen aspekteve të ndryshme siç janë: implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve.

Certifikimi ISO 9001 përfaqëson një konfirmim të faktit që shoqëria respekton një seri kërkesash të pranueshme në nivel ndërkombëtar. Mbajtja e certifikimit sjell disa përparësi për shoqërinë siç janë: akses tek procedurat e tenderave publike, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

ISO 14001-2015

ISO 14001 është një standard që i referohet sistemit të menaxhimit të mjedisit.

ISO 14001:2015 përqëndrohet tek identifikimi i atyre aktiviteteve që mund të gjenerojnë aspekte domethënëse në mjedis dhe tek aplikimi i masave kontrolluese. Qëllimi është ulja ose eliminimi i efekteve negative mbi mjedisin të lidhura me aktivitetet e shoqërisë.

Aplikimi i ISO 14001 ndihmon shoqërinë të përmirësojë performancën e saj mjedisore nëpërmjet uljes së sasisë të mbetjeve të gjeneruara dhe përdorimin me efikasitet të burimeve natyrore.

ISO 45001:2018

Çdo kompani ka detyrimin të mbrojtë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit.

ISO 45001 është standardi ndërkombëtar i cili përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në punë.

Kërkesat e standardit ISO 45001 përfshijnë: vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Certifikimi ISO 45001 mund të merret nga çdo kompani, pavarësisht aktivitetit të saj si dhe risqeve të shëndetit dhe sigurisë.

Ky certifikim konfirmon angazhimin e shoqërisë për të marrë masat e nevojshme për të mbrojtur punonjësit e saj dhe të çdo personi tjetër në ambientet e saj.

2.3.7. Me anën e një deklaratë, operatori ekonomik duhet të përcaktojë inxhinierin e fushes si inxhinier mjedisi, pyjesh, agronom për ndjekjen dhe zbatimin e plote të kontratës përgjegjesin e kësaj kontrate, pjesë të stafit të tyre, duke paraqitur kontaktet, diplomën, CV-në, kontratën e punës të vlefshme brenda periudhës së realizimit të kontratës dhe librezën e punës.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77, pika 4, si dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 40, pika 5 germa b/c, me anë të këtij kriteri kërkohet që, operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.8 Ofertuesi duhet të disponojë te vetat ose me qera këto **makineri**:

Pershkrimi	Sasia
Kamion me vinc	3 (tre) cope
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës te pakten min 10 ton	3 (tre) cope
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 1 – 3.5 ton	1 (nje) cope
Eskavator me goma	1 (nje) copë
Fadrome	1 (nje) copë
Minieskavator	1 (nje) cope
Minifadrome	1 (nje) cope
Damper kantieri	2 (dy) cope
Autobot Uji	2 (dy) copë
Kokore/Kapele mbrojtese	49 (dyzet e nente) copë
Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila	5 (pese) cope
Prozhektorë ndriçimi	5 (pese) cope
Komplet i ndimës së shpejtë	10 (dhjete) cope
Tabela paralajmëruese për bllokimin dhe devijimin e rruges	20 (njetzet) cope

Per te deshmuar ketë, Formulari i shtojces 8 te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtem:

- a) Makineritë dhe pajisjet me qira të shoqërohen me kontrata qiraje të lidhura para noterit publik, si dhe të shoqërohen me aktin e pronësisë të qiradhënësit (original ose fotokopje e noterizuar).

- b) Kohëzgjatja e kontratave të qerasë për makineritë/pajisjet në fjalë duhet të mbulojë të gjithë kohën e parashikuar në Grafikun e realizimit të kontratës.
- c) Për mjetet që shënohen në regjistrat publik me qera ose ne pronesi duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (Certifikatat pronësie, leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti). Për pajisjet e tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat e blerjes, origjinalë ose fotokopje e noterizuar. Të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara të jenë të shoqëruara me foto.

Në rast se dokumentet e mësipërme janë në gjuhë të huaj, ato detyrimisht duhet të shoqërohen me një përkthim në gjuhën e ofertes, si dhe noterizimin e nënshkrimit të përkthimit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë **mjetet e pajisjet teknike**, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i mjeteve ne pronesi / qira / kontrate furnizimi është minimal në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtësisht me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke marrë në konsideratë faktin se malli objekt kontrate do të transportohet nga furnizuesi në ambientin ku do të magazinohet apo do të mbillet/vendoset sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, shoqëruar me punimet përkatëse. Mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës.

Duke qënë se procesi i punës është i ndarë në dy drejtime (furnizim-vendosje) ku në dejetimin e vendosjes OE do të ndodhet në terren në zona të ndryshme ku do të kryhet procesi i mbjelljes nevojitet stafi i nevojshëm sipas profileve të sipërcituara për realizimin e kontratës. Gjithashtu edhe tek furnizimi, edhe tek vendosja, duke qënë se sasia e pemëve është e konsiderueshme dhe afati i lëvrimit është i përcaktuar, si dhe bazuar tek mjetet të cilat mund të funksionojnë me

turne të ndryshme në kuadër të thjeshtimit të procesit të mbjelljes duke ju referuar orareve të përshtatshme, në varësi të një sërë faktorësh, të tillë si terreni dhe rrugët brënda qytetit, trafikut të rënduar, kufizimeve të mundshme në orar në qarkullim, grafikut të punës, është i nevojshëm angazhimi i mjeteve dhe numrit prej 49 punonjësish të këkuar sipas profileve përkatës në respekt dhe në zbatim të kodit të punës.

2.3.9. Me ane të një deklaratë Operatori duhet të deklarojë dakordësinë e tij për garanci për 2 vjet për produktet që janë furnizim-vendosje - objekt i kontratës dhe që do të ofrojë për të njëjtën periudhë të gjitha shërbimet e mirembajtjes së zakonshme.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u garantuar se për një periudhë të arsyeshme prej 2 vitesh objekt i këtij prokurimi do të përmbushin specifikimet teknike dhe do të mbulohen të gjitha problematikat që mund të lindin, por jo për faj të Autoritetit.

2.3.10. Ofertuesi të paraqesë, përpara afatit të fundit për hapjen e ofertave, nga një mostër për artikujt e mëposhtëm:

1. Pishë e butë (Pinus Pinea), me perimetër 45_50 cm në 1.3 m nga toka) / artikulli Nr. 7 në preventiv.
2. Rrap, (platanus orientalis), (me perimetër 80_85 cm në 1.3m nga toka) / artikulli Nr.11 në preventiv.
3. Rrap, (platanus orientalis), (me perimetër 60_70 cm në 1.3m nga toka) / artikulli Nr. 12 në preventiv.
4. Panjë e kuqe (me perimetër 40_45 cm në 1.3m nga toka) / artikulli Nr. 22 në preventiv.
5. Tespie (me perimetër 45_50 cm në 1.3m nga toka) / artikulli Nr.28 në preventiv.

6. Cedër (Cedrus Deodora), (me perimetër 55_60 cm në 1.3 m nga toka) / artikulli Nr. 36 në përvetësim.

Mostrat të paraqiten dhe të dorëzohen në magazinën e DPPGJ (përkatësisht në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, Rruga 5 Maji, Tiranë), së bashku me listën e mostrave të protokolluar në DPPGJ përpara afatit të fundit për paraqitjen e ofertave. Një kopje e listës së mostrave të protokollohet dhe të dorëzohet në zyrën e protokoll-arkives në DPPGJ.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nën të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nën të 40, pika 6/a dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe Udhezimit nr. 03 datë 12.04.2022 “Mbi Procesin e Administrimit të Mostrave të paraqitura nga Operatorët Ekonomikë”.

Paraqitja e mostrave të kërkuara lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Autoriteti Kontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nënligjorë të nxjerra në zbatim të tij, për të kërkuar mostrat e mallrave, objekt prokurimi, për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike, Vetë Komisioni i Prokurimit Publik lidhur me këtë kriter, arsyeton: ...”KPP konstaton se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kriteret e tjera kualifikimi, të cilat lidhen me vërtetimin e plotësisht të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave për të gjitha artikujt objekt prokurimi...”

Qëllimi i vendosur nga ligjvënësi për paraqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kriteret e tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi janë hartuar nga grupi i punës referuar praktikës e cila është pjesë e dosjes së prokurimit, miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor/ Personi i Autorizuar, bazuar në parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, , nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo dhe çdo standardi të kërkuar.

Pas finalizimit të këtij procesi për përgatitjen e specifikimeve teknike, grupi i punës, bazuar në nenet 34 dhe 36 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenet 12, 13, nenin 45 pika 2.1 76 të VKM Nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, filloj punën për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës objekt prokurimi, **bazuar pikës b/ të nenin 76 të VKM-së nr.285**, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në përllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet të referohet një osë më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit:

Bazuar në nenin 76 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në përllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet të referohet një osë më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) *çmimet e botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe*
- b) *studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- c) *çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
- ç) *çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

Sa i përket respektimit të gërmes “b”, Grupi i Punës, bazuar në rregullat e tregut, ka kryer studimin e tregut nëpërmjet marrjës së ofertave, për të njohur për aq sa është e mundur, nivelin e tregut aktual. Operatorët Ekonomik të përzgjedhur në mënyrë rastësore për marrjen e ofertave për testimin e tregut, janë subjekte tregtare të licensuara dhe të regjistruar pranë QKB dhe referuar objektit të veprimtarisë së tyre të publikuara në faqet on-line respektive, por edhe sipas Ekstraktit të Regjistrimit publikuar në faqen zyrtare on-line të QKB, rezultojnë se kanë në objektin e veprimtarisë së tyre, fushën objekt prokurimi.

Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Të gjitha kriteret në mënyre më të hollësishme pasqyrohen në DST dhe konkretisht në Shtojcën 7 të “**KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**”, që ndodhen në dosjen e tenderit objekt prokurimi.

**OBJEKTET E MBJELLJES SË BIMËSISË DEKORATIVE (F.V.) TË
MATRIALIZUARA ME KOORDINATAT E VENDNDODHJES**

2 - F.V. Bli, (*Tilia platyphyllos*), (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka), rruga "Muhamet Deliu" me këto koordinata:

- 41.345939, 19.856369 - 41.350425, 19.868976
- 41.350071, 19.867436 - 41.351536, 19.867036 - 41.349213, 19.858579
- 41.350115, 19.865821
- 41.350373, 19.866960

3 - Tirane - Kashar (krahu i QTU), rruga “Industriale” sipas koordinatave të mëposhtëme:

F.V. Bli, (*Tilia platyphyllos*), (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka)-

F.V. Manjolë, (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka)

F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka)

- 41.343828, 19.774420 - 41.351654, 19.751880

5 - F.V. Bli, (*Tilia platyphyllos*), (me perimetër 40_45 cm në 1.3 m nga toka), përballë ETC, me koordinata sim ë poshtë:

- 41.323986, 19.822460 - 41.324198, 19.823465

7 - F.V. Pisha e Bute (*Pinus Pinea*), (me perimetër 45_50 cm në 1.3 m nga toka), Autostrada TR-DR, me këto koordinata:

- 41.346376, 19.766073 - 41.365293, 19.707987

14 - F.V. Rrap, (*Platanus orientalis*), (me perimetër 20_25 cm në 1.3 m nga toka), rruga “Monun”.

F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka). rruga Monun, me koordinata:

- 41.358836, 19.731138 - 41.363800, 19.714055

15 - F.V. Rrap, (*Platanus orientalis*), (me perimetër 20_25 cm në 1.3 m nga toka). rruga “Egnatia”.

F.V. Manjolë, (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka), rruga “Egnatia”.

F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka), rruga “Egnatia”.

F.V. Dafine (*Laurus nobilis*), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), rruga “Egnatia”, sipas koordinatave të mëposhtëme:

- 41.364044, 19.713964 - 41.370755, 19.702650

17 - F.V. Pishe e Bute, (me perimetër 20_25 cm në 1.3 m nga toka), lulishte prane “Megatek”

F.V. Lis (*Quercus*), (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka), lulishte prane “Megatek”

F.V. Likuidambër, (*Liquidambar styraciflua*), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), lulishte prane “Megatek”.

F.V. Sofor (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), lulishte prane “Megatek”, me koordinata sim ë poshtë:

- 41.369419, 19.703739
- 41.370237, 19.703975
- 41.370027, 19.703311
- 41.370491, 19.703005

18 - F.V Ulli, (*Olea Europaea*), (me perimetër 130_140 cm në 1.3 m nga toka), lulishte prane “Mbikalimi te Kashar”, me koordinata sim ë poshtë:

- 41.365921, 19.705273
- 41.365744, 19.705940
- 41.366901, 19.704504

23 - F.V. Rrap, (*Platanus orientalis*), (me perimetër 20_25 cm në 1.3 m nga toka), rruga “Iliria”, me koordinata sim ë poshtë:

- 41.361306, 19.721210 - 41.365655, 19.704666

24 - F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 40_45 cm në 1.3 m nga toka), rruga “Bylis”.

F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 40_45 cm në 1.3 m nga toka), rruga “Bylis”.

F.V. Likuidambër, (*Liquidambar styraciflua*), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), rruga “Bylis”.

F.V. Likuidambër, (*Liquidambar styraciflua*), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), rruga “Bylis”.

F.V. Liriodendron (*Liriodendron tulipifera*), (me perimetër 18_20 cm në 1.3 m nga toka), rruga “Bylis”, me koordinata si më poshtë:

- 41.351755, 19.751596 - 41.358606, 19.731850

“Cassa Italia” - “Kashar” (krahu Vodafone)

25 – F.V. Lis, *Quercus*), (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka), rruga “Pavarsia”, me këto koordinata:

- 41.343423, 19.773606 - 41.354020, 19.742861

26 - F.V. Sofor (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), rruga “Dardania”, me këto koordinata:

- 41.354423, 19.742059 - 41.358534, 19.730225

27 - F.V. Rrap, (*Platanus orientalis*), (me perimetër 20_25 cm në 1.3 m nga toka), rruga Butrinti, me këto koordinata:

- 41.358580, 19.730083 - 41.361268, 19.721382

29 - F.V. Qershi Japoneze (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), rruga “Asim Zeneli”, me këto koordinata:

- 41.319897, 19.823550 - 41.320437, 19.826135

31- F.V. Bli, (*Tilia platyphyllos*), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), rruga “Besim Alla”, me këto koordinata:

- 41.318516, 19.775587 - 41.324574, 19.773975

32- F.V. Bli, (*Tilia platyphyllos*), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), rruga “Thoma Koxhaj”, me këto koordinata:

- 41.318471, 19.775330 - 41.319379, 19.772475

35 - F.V. Cedër, (*Cedrus Deodara*), (me perimetër 55_60 cm në 1.3 m nga toka), Kryeministria, me këto koordinata:

- 41.321922, 19.821691

40 - F.V. Ahu, (*Fagus sylvatica*), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), Zall-Bastar, me këto koordinata:

- 41.428580, 19.932504

43 - F.V. Ahu, (*Fagus sylvatica*), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), Shengjergj, me këto koordinata:

- 41.328813, 20.091717

46 - F.V. Kumbull e Kuqe, (*Prunus Pissardi*), (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka), tek rruga "E Kavajës, me këto koordinata:

- 41.328164, 19.815494 - 41.326391, 19.805516

49 - F.V. Liriodendron (*Liriodendron tulipifera*), (me perimetër 18_20 cm në 1.3 m nga toka), tek rruga "Ana Konmena", me këto koordinata:

- 41.333513, 19.794916 - 41.334923, 19.791526

52 - F.V. Bli, (*Tilia platyphyllos*), (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka), rruga “Diga e Liqenit”, me këto koordinata:

- 41.308494, 19.863881 - 41.308414, 19.868752

53 - F.V. Lisi i Kalifornisë, *Quercus Agrifolia*, (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), rruga e “Vilave”, me këto koordinata:

- 41.283950, 19.858656 - 41.274863, 19.867003

58 - F.V. Panjë e Norvegjisë, *Acer platanoides* 'Crimson King' (Norway Maple), (me perimetër 18_20 cm në 1.3 m nga toka), rruga “Lek Dukagjini”, me këto koordinata:

- 41.317137, 19.819694 deri 41.317661, 19.822967

67- F.V Oleandër, (*Nerium oleander*), parteri i mesit rruga “E Dibres”, me këto koordinata:

- 41.341971, 19.832832 - 41.345918, 19.840846

68 - F.V Oleandër, (*Nerium oleander*), parteri i mesit rruga “Kastriotet”, me këto koordinata:

- 41.344038, 19.776403 - 41.360419, 19.772080